



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 5801 Prot

Lezhë, më 05 / 05 /2026

VENDIM

Nr. 38, Datë 30. 04. 2026

PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË NDËRMARRJES LEZHA INVEST SH.P.K. TË STACIONEVE PUBLIKE TË PLAZHIT NË BASHKINË E LEZHËS DHE PËRCAKTIMIN E TARIFAVE MAKSIMALE PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT NË PLAZHET PUBLIKE NË ADMINISTRIM TË LEZHA INVEST

Në mbështetje të nenit 8, pika 1, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "a", nenit 23, pika 14, nenit 33, pika 1, shkronja "ç", nenit 54, nenit 55, nenit 64, shkronja "c" të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 113 të "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; nenit 4/1 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin territorit" (i ndryshuar), nenit 6, 6/1, 9, 11 dhe 13 të Vendimit nr. 649, datë 16.10.2024 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", me qëllim përdorim të uniformuar të hapësirës publike stacion plazhi dhe krijimin e një mjedisi me shërbime të rregullta dhe funksionale turistike në shërbim të komunitetit, me propozim të subjektit Lezha Invest shpk dhe Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

1. Vënie në dispozicion të ndërmarrjes 'Lezha Invest sh.p.k.' në pronësi të Bashkisë Lezhë me NUIS M181165070 të sipërfaqeve publike stacione plazhi për shfrytëzim për ofrimin e shërbimeve turistike për pushues për sezonin turistik veror 2026.
2. Këto sipërfaqe i vihen në dispozicion për periudhën Maj 2026 – Tetor 2026.
3. Të miratojë në parim Planin e Veprimit të ndërmarrjes 'Lezha Invest sh.p.k.', bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të përcaktojë si tarifa tavan për ofrimin e shërbimit në stacione plazhi publike sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Ndërmarrja ka të drejtën që për ofrimin e shërbimit turistik të ndërtojë marrëdhënie ekonomike-financiare me operatorë që ofrojnë shërbime plotësuese.
6. Ndërmarrja nuk ka të drejtë ta ofrojë këtë hapësirë me qera operatorëve të tjerë apo ta shfrytëzojë bashkarisht me operatorë të tjerë.

7. Ndërmarrja ka detyrimin që të organizojë me shpenzimet e veta dhe në përputhje me Planin e vet të Biznesit, shërbimet turistike në parcelat e sipërshënuara.

8. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për hartimin e dokumentacionit dhe dorëzimin e hapësirës ndërmarrjes Lezha Invest sh.p.k. dhe organizimin e punës për inspektimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
LEZHA INVEST SH.P.K
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Nr. 548 Prot.

Lezhë, më 28/4 /2026

V E N D I M

Nr. 170, datë 28/4 /2026

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË PLAZHEVE PUBLIKE NË
BASHKINË LEZHË PËR VITIN 2026”**


Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetë-Qeverisjen Vëndore” I ndryshuar, sipas ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar; ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin” të ndryshuar; ligjit nr. 8743, datë 22/02/2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, Ligjit nr.9251, datë 08/07/2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar; Vendimit nr.649, date 16/10/2024 i ndryshuar me Vendim nr.60, datë 28/01/2026 të Keshillit të Ministrave, Për Miratimin e Rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”; Vendim VKB Nr. 112 datë 29.06.2021 “Për krijimin e Shoqërisë “Lezha Invest” sh.p.k si Përsôn Juridik në Pronësi të Bashkisë Lezhë”; VKb-së nr. 22 datë 26.02.2025; sot në datë datë ___/___/ 2026 në selinë e shoqërisë “LEZHA INVEST” sh.p.k e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT M181165070, u mbajt Asambleja e Shoqërisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë Lezha Invest sh.p.k të përfaqësuar nga administratori Z. Besmir Frroku, “Kërkesë për miratimin e “Planit të Menaxhimit të Plazhëve Publike në Bashkinë Lezhë për vitin 2026” përgatitur nga Lezha Invest (bashkëngjitur kësaj kërkesë gjithësej 21 faqe).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

PËRFAQËSUAR NGA KRYETARI



LEZHA INVEST SH. P.K, NUIS M181165070, adresa: Sheshi “Gjergj Kastrioti”, Lezhë



PLANI I MENAXHIMIT TË PLAZHEVE PUBLIKE NË BASHKINË LEZHË PËR VITIN 2026

Përgatitur nga

LEZHA INVEST sh.p.k



Bashkia Lezhë



HYRJE

Ne mbështetje të vendimit Nr:60, datë 28/01/2026 I Keshillit të Ministrave i cili sjell ndryshime dhe shtesa në vendimin 649, date 16/10/2024, që lidhet me miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacioneve të plazheve dhe në mbështetje të vendimit nr.16 date 16/06/2025.

Bashkia Lezhe, që në vitin 2025 ka filluar ta organizojë këtë shërbim si pjesë e aktivitetit të vet ekonomiko-financiar, me angazhimin e ndërmarrjes publike "Lezha Invest shpk", e cila ka në fokus kryesor ofrimin e shërbimeve në mënyrë të drejtpërdrejtë për plazhet publike krahas shërbimit që ofrohet në plazhet e menaxhuara nga Njësia Vendore Bashkia Lezhë.

Ndërmarrja publike 'Lezha Invest SH.P.K' është krijuar në respektim të Ligjit nr. Nr.9901, datë 14.4.2008 "PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE", Vendim VKB Nr. 112 datë 29.06.2021 "Për krijimin e Shoqërisë "Lezha Invest" sh.p.k si Përsôn Juridik në Pronësi të Bashkisë Lezhë"; e cila zhvillon veprimtarinë në mënyrë të pavarur. Ajo është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në datë 16 Korrik 2021 me NIPT M181165070 , me seli në Sheshi "Gjergj Kastrioti", 4501, Lezhe. Anëtarësia e saj përbëhet nga ortaku i vetëm , Bashkia Lezhë , që zotëron 100% të kapitalit themeltar. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimtaritë tregëtare sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkia e Lezhës ka treguar se ka potencialin për të zhvilluar dhe menaxhuar stacionet e plazheve publike në mënyrë që të ofrohen shërbime cilësore për banorët dhe vizitorët, pas eksperiencës së vitit 2025. Synimi nuk është vetëm të përmirësojë jetën e përditshme të qytetarëve, por edhe do të nxisë turizmin dhe ekonominë lokale.

Duke u bazuar në problematikat e konstatuara gjatë vitit 2025, qëllimi për vitin 2026 është të sigurohet një menaxhim financiar i qëndrueshëm, duke balancuar aksesin e kategorive sociale me optimizimin e të ardhurave, si dhe analizimin e strukturës së tarifave të shërbimeve të propozuara nga "Lezha Invest" për sezonin turistik 2026.

Për vitin 2026 synimi ynë është të ofrojmë shërbimin për rreth 2500 cadra në plazhe publike të cilat do të kemi në administrim dhe menaxhim.



QËLLIMI

Qëllimi i përgjithëm i ndërmarrjes "Lezha Invest shpk" është mirë administrimi i aseteve publike në pronësi të Bashkisë Lezhë duke u bërë një faktor i rëndësishëm i menaxhimit të ardhurave që mund të përfitohen nga mirë menaxhimi i tyre. Për këtë arsye është menduar që në objektin e aktivitetit të kompanisë Lezhë Invest të përfshihet një gamë e gjërë funksionesh në mënyrë që kompania të jetë sa me fleksibël dhe të jetë avangard me kërkesat e tregut.

Sa i takon fushës së menaxhimit të plazheve publike në Bashkinë Lezhë, synimi është;

- Rritja e të ardhurave për Bashkinë e Lezhës përmes menaxhimit efektiv.
- Ofrimi i shërbimeve të cilësishme në plazhet publike.
- Promovimi i turizmit dhe përdorimi racional i burimeve natyrore.
- Sigurimi i një ambienti të pastër dhe të sigurt për vizitorët

SITUATA EKZISTUESE E PLAZHEVE

Për të kuptuar situatën ekzistuese të menaxhimit të plazheve në Bashkinë e Lezhës, duhet të merren parasysh disa faktorë, duke përfshirë gjendjen aktuale të infrastrukturës, shërbimet e ofruara, menaxhimin e mjedisit dhe përdorimin e plazheve nga banorët dhe vizitorët. Aktiviteti i plazhit në Bashkinë Lezhë shtrihet në tre plazhe kryesore; Plazhi i Ranës së Hedhun, Plazhi i Shëngjinit-Kune-Vain dhe Plazhi i Tales.

Gjendja e plazheve: Plazhet në Lezhë janë kryesisht natyrore dhe kanë potencial të madh për zhvillim. Megjithatë, sfida mbetet infrastruktura e kufizuar ose e vjetëruar (p.sh., mungesa e tualeteve publike, dushave, ose zonave të hijezuara).

Shërbimet: Shërbimet ofrohen kryesisht cadra me qira ditore të përballueshme, dusha dhe akses në beach bare.

Pastrimi dhe mirëmbajtja: menaxhohet nga subjekti Lezha Invest shpk për pastrimin e mbeturinave në plazhet e menaxhuara, veçanërisht gjatë sezonit turistik.

Roli i bashkisë: Në skemën ekzistuese Bashkia e Lezhës ka një rol kufizuar në menaxhimin e plazheve, duke u fokusuar kryesisht në sigurimin e rregullave ligjore dhe në kontrollin e stacioneve të plazhëve.



Sfidat dhe Mundësitë

Sfidat

- Krijimi i hapësirave publike të mjaftueshme për turistët që nuk duan të paguajnë për qira ditore për shezllone.
- Ulja e çmimeve të qirasë dhe ndikimi në kërkesën e turistëve.
- Përshtatja me kërkesat e një audience të diversifikuar, përfshirë turistët me buxhet të ulët por edhe duke bërë një shpërndarje të turizmit në të gjithë vijën bregdetare.

Mundësitë

- Diversifikimi i shërbimeve: Shtimi i aktiviteteve si sportet ujore, masazhet në plazh, shërbime beach- bare, fusha sportive volejbolle etj).
- Paketa familjare dhe abonime për të nxitur qëndrimin afatgjatë.
- Marketing digjital dhe realizmin e platformes online për rezervime apo te kontrollit online ne kohe reale te mbulimit të cadrave nga pushuesit.

TREGU I SYNUAR

Për të siguruar suksesin dhe rritjen e aktivitetit tonë në shërbimin e plazheve të Lezhes, kemi identifikuar tregun e synuar duke u bazuar në profilin e klientëve potencialë, sjelljen e tyre dhe preferencat që kanë gjatë pushimeve.

Turistë Vendas dhe Rajonalë

Turistët vendas

Pushues nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut - Ky grup përbën shumicën e turistëve që vizitojnë Shëngjinin, kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht. Ata kërkojnë:

- Shërbime cilësore dhe ambient familjar.
- Komoditet dhe çmime të arsyeshme.
- Lehtësi në aksesin në plazh dhe shërbime të shpejta.

Turistë Ndërkombëtarë

- Janë të gatshëm të paguajnë më shumë për shërbime cilësore.
- Preferojnë shezllone cilësore, ambiente të pastra dhe shërbime të personalizuar.



Familjet me Fëmijë

Ky grup përfaqëson një pjesë të madhe të turistëve që qëndrojnë për periudha më të gjata:

- Kërkojnë hapësira të sigurta dhe të pastra, çadra të mëdha dhe shërbime ushqimore pranë plazhit.
- Interesohen për aktivitete për fëmijë, si lojëra në rërë ose aktivivete sportive sipas grupmoshave dhe animacione.

Rinia dhe Grupet e Miqve

Ky segment kërkon argëtim, muzikë live, evente dhe aktivitete sportive në plazh:

- Janë të interesuar për festa në plazh, koktejlle dhe shërbime.
- Kërkojnë paketa me sporte ujore si jet ski, paddle board, volejball plazhi.
- Kanë tendencën të rezervojnë në grup dhe janë më aktivë në rrjetet sociale.
- Pushuesit sezonalë (qershor - shtator) përbëjnë shumicën e klientëve.
- Rezervimet online dhe parapagimet po bëhen më të zakonshme, sidomos për turistët e huaj.
- Shërbimi cilësor dhe pastërtia janë faktorë kyç në zgjedhjen e shezlloneve.
- Çmimi është i rëndësishëm duke u pershtatur teresisht me tregun e targetuar.

Strategjitë për të Tërhequr Tregun e Synuar

- Reklamim i synuar në rrjetet sociale, sidomos për grupmoshat e reja dhe turistëndërkombëtarë.
- Evente dhe aktivitete special në bashkpunim me Bashkinë Lezhë për të rritur angazhimin e klientëve dhe për t'i bërë ata të kthehen sërish.

SEGMENTIMI I TREGUT

Segmentimi i tregut për shërbimin e plazhit në Bashkinë Lezhë ofron mundësi për të synuar grupe të ndryshme klientësh, nga ata që kërkojnë përvojë të qetë dhe të përballeshme, deri te ata që preferojnë shërbime të nivelit të lartë dhe aktivitete dinamike.



Turistë sipas Buxhetit

Turistë me Buxhet të Ulët

Kërkojnë mundësi të përballeshme për të kaluar një ditë në plazh, pa shumë shërbime shtesë.

Turistë me Buxhet të Mesëm

Preferojnë mundësi më të lira, por që përfshijnë disa shërbime shtesë si pije dhe aktivitete.

Përvojë e kërkuar: Paketa standarde me disa mundësi për aktivitete dhe konsum ushqimi dhe pije.

Turistë me Buxhet të Lartë

Ata kërkojnë shërbime të veçanta dhe janë të gatshëm të paguajnë për shërbime premium dhe ambiente ekskluzive.

Përvojë e kërkuar: Shezllone dhe çadra VIP, ushqim dhe pije të nivelit të lartë, shërbime spa dhe aktivitete të veçanta.

Përvojë e kërkuar: Shezllone standarde me çmime të ulëta dhe mundësi për të përdorur hapësirën publike.

SKEMA E ORGANIZIMIT TË SHËRBIMIT DHE TARIFIMIT

Analiza e Strukturës së Tarifave

- **Tarifa 300 ALL:** Siguron akses të gjerë për shtresat sociale, duke garantuar pjesëmarrje masive.
- **Tarifa 500 ALL:** Përfaqëson nivelin standard, duke gjeneruar të ardhurat kryesore të operatorit.
- **Tarifa 700 ALL:** Ofron komoditet shtesë, duke rritur të ardhurat mesatare për klient.
- **Tarifa 1500-2000 ALL:** Shërbim premium, i cili zgjeron ofertën dhe targeton klientët me kërkesa më të larta.

Shërbimet janë organizuar sipas plazheve si më poshtë;

Shërbimi	Tarifa (ALL)
Çader kashte / Shezlong alumini	300
Çader alumini / Shezlong alumini	500
Çader alumini + kashte / Shezlong dyshek	700
Cabana (Gazebo plazh)	1500-2000



Tarifë shërbimi Tale :

Çader kashte / Shezlong alumini	300 ALL
Çader alumini / Shezlong alumini	500 ALL
Çader alumini + kashte / Shezlong dyshek	700 ALL
Cabana (Gazebo plazhi)	1500-2000 ALL

Tarifë shërbimi Shëngjin:

Çader kashte / Shezlong alumini	400 ALL
Çader alumini / Shezlong alumini	500 ALL
Çader alumini + kashte / Shezlong dyshek	700 ALL
Cabana (Gazebo plazhi)	1500-2000 ALL

Tarifë shërbimi Rana Hedhun:

Çader alumini / Shezlong alumini	500 ALL
Çader alumini + kashte / Shezlong dyshek	700 ALL
Cabana (Gazebo plazhi)	1500-2000 ALL

Kategoritë e Shërbimeve

Shërbimet janë ndarë sipas nivelit të komoditetit dhe kostove operative:

- **Shërbimi bazë:** Çadra kashte dhe shezlongë alumini/druri - alternativë ekonomike, siguron frekuentim të lartë ditor.
- **Segmenti standard:** Çadra alumini dhe shezlongë alumini - baza kryesore e të ardhurave.
- **Segmenti me vlerë të shtuar:** Shezlongë me dyshek dhe gazebot - rrit të ardhurat mesatare për njësi shërbimi.
- **Cabana/Gazebo plazhi:** Shërbim premium, i orientuar drejt klientëve me kërkesa më të larta për komoditet.



Lezha Invest ka buxhetuar blerjen e makinerise se pastrimit te reres dhe mirëmbajtjen e plazhit. Një shëmbull i tipit të makinerisë që synohet të përdoret është dhënë në imazhin e mëposhtëm.



Figure 1 Makineri pastrimi të rërës (foto ilustruese)

Përveç këtyre pajisjes me anë të të ciles bëhet pastrimi reres, për vitin 2025 është mundësuar pastrimi mbi baza ditore të parcelave me grabuja, në zona ku ka çarkullim intensive të pushuesve në mënyrë manual nga punonjësit e shërbimit.



Figure 2 mjete te pastrimit të rërës

Gjithashtu plazhet do të pajisen edhe me kosha për mbeturina. Mbledhja e këtyre mbeturinave dhe largimi i tyre drejt vendpikave të mbetjeve do të realizohet nga punonjësit e shërbimit, ndërsa largimi i tyre drejt vend depozitimit të mbetjeve do të realizohet përmes shërbimit të Bashkisë Lezhë





Plazhet janë të pajisur me sinjalistikën e duhur. Stacionet e plazhit kanë sinjalistikë me informacione për plazhin.



PLAZH PUBLIK I MENAXHUAR



- HYRJA PER PUSHUESIT ESHTË E LIRE DHE PA PAGESË.
- OFROHET SHERBIMI I SIGURISE NE PLAZH.
- OFROHET SHERBIMI I PASTRIMIT TE AMBIENTIT.

- NE MENYRE OPSIONALE OFROHET SHERBIMI I ÇADRAVE.
- TARIFA E OPSIONIT TE ÇADRAVE TE PLAZHIT ESHTË 400 LEK/DITE.

Figure 3 Tabele informuese mbi stacionin e plazhit



Sinjalistika siguron publikimin e rregullave të sigurisë në plazh, duke përfshirë edhe numrat e kontaktit të emergjencave, policisë dhe ndërhyrjes së shpejtë.



PLAZH PUBLIK I MENAXHUAR



RREGULLAT E ARTA

- 1 NOTO VETËM NË ZONAT E AUTORIZUARA DHE ME SINJALISTIKË;
- 2 RESPEKTO FLAMURIN DHE INFORMACIONIN E AFISHUAR;
- 3 NDALOHEM NOTIMI NËN NDIKIMIN E ALKOOIT APO DROGAVE;
- 4 MOS NOTO NËSE KE NDONJË PROBLEM FIZIK;
- 5 PUSHO PËR NJË ORË PAS NGRËNIES PARA SE TË SHKOSH PËR NOTIM;
- 6 TË MITURIT NËN 16 VJEC DUHET TË JENË ÇJTHIMONË NËN MBIKËQYRJEN E NË TË RRITURVE;
- 7 MOS U HIDH NGA SHKËMBINJ APO PLATFORMA PËRVEÇ VENDEVE TË AUTORIZUARA ME SINJALISTIKË;
- 8 NDIQ UDHËZIMET E VROJTUESIT (RDJES SE SHPETIMIT TË JETES);
- 9 MBANI PASTER MJEDISIN;
- 10 NË RAST EMERGJENCE NË DET TELEFONO 112.

**FLAMUR I GJELBËR
LEJOHET NOTIMI**

**GREEN FLAG
SAFE TO SWIM**

**FLAMUR I VERDHË
NOTO ME MASA MBROJTËSE**

**YELLOW FLAG
CAUTION REQUIRED
DANGEROUS SWIMMING**

**FLAMUR I KUQ
NDALOHEM NOTIMI**

**RED FLAG
NO SWIMMING**

NUMRAT E EMERGJENCAVE/ SOS

127 AMBULANCA	128 ZJARRËFIKËSE
129 POLICIA E SHPETIMIT	125 SHËNJA KOOPERATIVE OPERACIONALE DETARE
VHF-16 KAPITENERIA DETARE	SOS 112 SHËNJA I EMERGJENCËS

Në skemën e organizimit Shoqëria 'Lezha Invest sh.p.k.' përfshin edhe shërbimin e sigurisë së jetës në plazhe përmes vrojtuesve të plazhit [Lifeguards], të cilët trajnohen dhe certifikohen nga një strukturë e përcaktuar për këtë qëllim.

Secili stacion plazhi publike do të mbulohet me Pika Vrojtimi ku do të ofrohet shërbimi i mbikqyrjes dhe sigurisë në plazhe.



Figure 5 Shërbimi i mbikqyrjes Vrojtimit në Stacion Plazhi Publik



Për çështje sigurie është planifikuar që të vendosen edhe bova sinjalizuese të shiritit të sigurisë së notimit të pushuesve, apo edhe për korridoret e sigurisë së lëvizjes së mjeteve motorrike në det, në afërsi të plazheve publike. Më poshtë janë dhënë disa shëmbuj të vendosjes së kësaj sinjalistike




Figure 6 Shëmbuj të sinjalizuesve të shiritave të lejuara të notimit

Avantazhet Konkurruese të Biznesit Tonë

Diferencimi në Shërbim dhe Përshtatshmëri

Shërbime të personalizuar: Ofrimi i shezlloneve dhe çadrave me mundësi për të krijuar paketa ekskluzive dhe mundësi për të zgjedhur aktivitete të personalizuar (sporte ujore, evente etj).

Përkushtimi ndaj cilësisë: Duke ofruar një ambient të pastër, të sigurt dhe komod, mund të krijojmë një përvojë të shkëlqyer klienti, duke i bërë ata të kthehen.

Teknologjia dhe Rezervimet Online

Rezervim dhe menaxhim online: Ofrimi i mundësisë për të rezervuar shezllone dhe aktivitete online do të ndihmojë për të tërhequr klientët që preferojnë të planifikojnë përpara.

- Ndërtimi i sturtupit tonë me hartën e plazhëve nën menaxhim.
- Faqja aktive ne [ëeb Lezha Invest.al](http://ëeb.LezhaInvest.al)
- Marketing efektiv dhe i orientuar tek grupet target: Duke përdorur kanale sociale dhe reklama të personalizuar, mund të arrijmë dhe tërheqim turistët që kërkojnë përvoja unike.

MUNDËSITË E REJA TË TREGUT.

Mundësitë e reja për tregun e shërbimit të plazhit në Bashkinë Lezhë janë të shumta dhe të larmishme. Disa mundësi kryesore për të shfrytëzuar janë zhvillimi i, sporteve ujore, turizmit ekologjik, ngjarjeve dhe aktiviteteve speciale.

Përdorimi i teknologjisë dhe aplikacioneve për rezervime online gjithashtu është një mundësi për të tërhequr një audiencë më të gjerë. Me një strategji të kujdesshme dhe të mirëplanifikuar, këto mundësi mund të sjellin një rritje të qëndrueshme dhe diferencim nga konkurrentët.


Ofrimi i Shërbimeve të Rezervimit Online dhe Aplikacioneve Mobile Me rritjen e përdorimit të teknologjisë dhe aplikacioneve, një mundësi tjetër është krijimi i një platforme të thjeshtë online për rezervimin e shërbimeve.

Ku mund të përfshijë:

- Rezervim të shezlloneve dhe aktiviteteve përpara se të arrijnë klientët në plazh nëpërmjet sturtupit të dedikuar.
- Sturtup për të menaxhuar rezervimet, të ofrosh informacion në kohë reale për disponueshmërinë e shërbimeve, dhe të ofrosh mundësi për promovime dhe oferta speciale. Kjo mund të ndihmojë për të tërhequr një audiencë më të gjerë dhe për të rritur komoditetin e klientëve.
- Zhvillimi i Ngjarjeve dhe Festave në hapësira të ndryshme të plazheve.

Lezha është një destinacion turistik me mundësi për të ofruar ngjarje speciale që mund të tërheqin turistët:

- Koncerte dhe Festat në Plazh UNUM FESTIVAL: Organizimi i ngjarjeve muzikore, festivaleve dhe party-ve që mund të mbajnë turistët të angazhuar dhe të sigurojnë mundësi për të kaluar një përvojë më dinamike.
- Evente Tematike: Organizimi i ngjarjeve si "Festivali i Kulinarisë në Plazh" ose "Maratona e Sporteve Ujore të Rana e Hedhur" mund të shtojë diversitetin e aktiviteteve dhe tërheqjen për klientët.
- Organizimi i koncerteve dhe neteve festive pranë zonës së markates së Peshkimit Shëngjin (brënda portit) nga Lezha Invest do të jetë një risi për vitin 2026.



Regullore Ligjore dhe Licencat

Në Bashkinë Lezhë, si në çdo destinacion turistik, ka një sërë kërkesash ligjore dhe regullash që duhet të respektohen për të operuar në mënyrë të ligjshme dhe të suksesshme:

- **Licencat dhe Lejet e Nevojshme:** Duhet të merren leje për përdorimin e hapësirave publike dhe private në plazh, si dhe për ofrimin e shërbimeve turistike dhe aktiviteteve. Prosesi i marrjes së këtyre lejeve mund të jetë i ngadalshëm dhe kërkon dokumentacion të saktë dhe të plotë.
- **Standartet e Sigurisë dhe Higjienës:** Ka kërkesa të forta për sigurinë e klientëve, veçanërisht për shërbimet që ofrojnë aktivitete në ujë. Ky është një faktor kritik që mund të krijojë barrierë për ata që nuk janë të pajisur me resurse për të përmbushur këto kërkesa.

PRODUKTET DHE SHËRBIMET

Përshkrimi i Produkteve dhe i shërbimeve.

Kemi një gamë e gjerë produktesh dhe shërbimesh që synojnë të plotësojnë nevojat e çdo kategori vizitori, nga turistët e zakonshëm te ata që kërkojnë luks dhe rehati të lartë. Ofrimi i një përvoje cilësore dhe të personalizuar do të krijojë avantazh konkurrues dhe do të ndihmojë në tërheqjen dhe mbajtjen e klientëve. Për të krijuar një përvojë të këndshme dhe komode për pushuesit.


Kompania jonë është e orientuar të ofrojë një gamë të gjerë shërbimesh dhe produktesh që plotësojnë nevojat e vizitorëve. Më poshtë janë përshkruar produktet dhe shërbimet kryesore që po shohim të ofrojmë gjatë vitit 2026 e në vazhdim:

Shezllone dhe Çadra Plazhi

- **Shezllone standarde** - Shezllone të rehatshme, të përshtatshme për relaksim në rërë.
- **Shezllone premium** - Më të mëdha dhe me shtresa shtesë për më shumë komoditet.

Shërbime VIP dhe Zonat e Privatësisë

- **Shezllone (gazebo) me tenda private** - Një opsion luksoz për ata që dëshirojnë më shumë privatësi.
- **Shërbim kamarieri në vend** - Mundësi për të porositur ushqime dhe pije direkt nga shezlloni duke ndërvepruar me bizneset e zones.



Shërbime Shtesë dhe Komoditete

- Ëi-Fi falas - Po shohim mundësi bashkpunimi për të pasur internet falas në zonën e plazhit.

Aktivitete dhe Argëtim

- Sportet ujore - Mundësi për të marrë me qira jet ski, paddle board, kajak, etj.
- Sporte të ndryshme të lojës me top në rërë- jemi në fazën e koncept idesë për të organizuar një kamp të larmishëm të lojrave me top, volejbollë, futboll në rërë, palestër në natyrë duke identifikuar si zonë parkimin publik tek ura e gurit shëngjin.
- Muzikë live dhe DJ events - Organizimi i eventeve të socio-kulturore brënda portit shëngjin tek zona e merkatës.
- Kinema në plazh - Seanca filmash në mbrëmje për një përvojë unike

AKTIVITETETE MARKETINGUT

Përcaktimi i Strategjisë së Marketingut

Strategjia jonë e marketingut do të fokusohet në një qasje të integruar, duke përdorur mjetet digjitale për të tërhequr turistë dhe strategjitë tradicionale për të siguruar një prezencë të fortë e të qëndrueshme në këtë treg. Strategjia jonë e marketingut synon të rrisë ndërgjegjësimin për shërbimet tona, të tërheqë turistë dhe pushues vendas, si dhe të krijojë një bazë të qëndrueshme klientësh të rregullt. Për ta arritur këtë, do të përdorim një kombinim të kanaleve tradicionale dhe digjitale të marketingut.

Përdorimi i Marketingut Digjital

Rrjetet Sociale (Facebook, Instagram, TikTok)

- Publikimi i fotove dhe videove cilësore të shërbimeve tona.
- Investimi në reklama të targetuara në Google për të arritur turistët që kërkojnë pushime në Lezhe.
- Optimizimi i uebfaqes Lezha Invest.al për të dalë më lart në kërkimet e Google.
- Krijimi i një sturtupi të lehtë për përdorim ku klientët mund të rezervojnë shezllone online.
- Përfshirja e vlerësimeve dhe komenteve të klientëve për të ndërtuar besueshmëri.



Metodat e Drejtpërdrejta të Shitjes

Tabela Informative

- Vendosja e tabelave informuese në hyrjet kryesore të plazhit.

Shitjet Online dhe Rezervimet

- Sturtup i thjeshtë dhe i shpejtë për të rezervuar shezllonet dhe paketat e tjera.
- Mundësi për pagesa online dhe konfirmim të menjëhershëm të rezervimit.
- Aplikacion Mobil.
- Aplikacion për rezervime direkte nga telefoni, me mundësi për zbritje ekskluzive.
- Notifikime për ofertat speciale dhe eventet e plazhit.

Politikat e Pagesave

Pagesë e Paraparakshme për Shërbimet

- Për të minimizuar rrezikun e pagesave të vonuara ose të papaguara, do të aplikohet pagesa e menjëhershme ose e parapaguar për të gjitha rezervimet e shezlloneve.
- Klientët mund të paguajnë në dorë ose përmes platformave online gjatë rezervimit.

Rezervimet Online me Garanci të Pagesës

- Rezervimet e bëra online do të kërkojnë pagesë paraprake ose një depozitë të pjesshme për të garantuar që shezllonet janë të rezervuara dhe të paguara.
- Politika e anulimit do të përcaktojë nëse klientët mund të rimarrin një pjesë të pagesës në rast të anulimit brenda një afati të caktuar.

Teknologjia dhe Siguria në Pagesa

- Investimi në POS (Point of Sale) terminale për pagesat me kartë në plazh.
- Implementimi i sistemeve QR Code dhe NFC për pagesa të shpejta dhe pa kontakt.
- Përfshirja e pagesave me portofol dixhital (PayPal, Revolut, Apple Pay, Google Pay, etj.)



ANALIZA FINANCIARE

Investimi dhe Metodologjia për 2026

Duke qenë se që nga viti 2025 është ndryshuar metodologjia e shfrytëzimit të parcelave të plazhit, si dhe pas eksperiencës së krijuar, për vitin 2026 kemi propozuar ndryshime në cmime të shezlloneve duke i klasifikuar sipas tipologjise së shërbimit të ofruar. Në këtë kontekst, Bashkia ka vendosur të përdorë hapësirat e plazhit për interesa ekonomike, duke ofruar shërbime më të organizuara për pushuesit. Për këtë arsye, edhe për vitin 2026 në synojmë të marrim me qira shezlongët nga bizneset, duke siguruar një burim të ardhurash për këto subjekte dhe një shfrytëzim më efikas të infrastrukturës së plazhit. Ky model jo vetëm që ndihmon bizneset e prekura nga ndryshimi i rregullave, por gjithashtu krijon një sistem më të strukturuar dhe të menaxhuar për ofrimin e shërbimeve në plazh.

Menyra e bashkepunimit me subjektet private dhe perlllogaritja e cmimit të Qirase.

Për të përcaktuar çmimin e qerave se shezllongëve, janë marrë parasysh disa tregues të rëndësishëm që reflektojnë gjendjen dhe vlerën e tyre në kohë. Një nga faktorët kryesorë në këtë vlerësim është amortizimi për një periudhë 5-vjeçare, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në çmimin e shezllongëve.

Duke përdorur këtë periudhë amortizimi, çmimi i shezllongëve do të përcaktohet sipas gjendjes së tyre të tanishme, duke i ndarë në kategori.

Shezllongë me tipologji të ndryshme, perkatesisht në cmimet 3000-5000 All për set (1 cadër 2 shezlonge). Nëpërmjet procedurë të prokurimit publik për vitin do të kontraktojmë 2500 çiftë (cadër + 2 shezlongje).

Burimet Njerezore të miratuara për vitin 2026.

Administrator (Niveli 1)

Ky është niveli i parë dhe ka përgjegjësinë për mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve të ndërmarrjes Lezha Invest shpk.

Përgjegjesi Sektori (Niveli 3)

Specialisti i Finances, specialisti i Burimeve Njerëzore dhe dhe Juristi.



Puntori sezonale për menaxhimin e plazhëve për vitin 2026:

Për vitin 2026 kemi planifikuar që të kemi 25 stacione plazhi të menaxhuara me pagesë ku do të vendosim 2500 çadra (përlllogaritet 100 çadra - 1 stacion plazhi).

Total 50- Punonjës të Shërbimeve (Niveli 4)

Punonjësit janë përgjegjës për sigurinë e pushuesve, menaxhimin dhe pastrimin e shezllonëve me dy punonjës për çdo 100 shezllone. Orari i punës: 08:00 - 18:00 (me dy turne)

Total 25- Punonjës Lifeguard

Total 6- Kontrollor

Mbeshtetja

Bashkëpunim midis Bashkisë Lezha dhe Lezha Invest sh.pk synon të nxisë zhvillimin ekonomik lokal përmes një mekanizmi financiar të strukturuar. Në këtë marrëveshje, në vitin 2025 Bashkia Lezha ka dhënë një hua prej 300,000 euro me afat kthimi të pacaktuar, duke u angazhuar në mbështetjen dhe zhvillimin e projektit Lezha Invest sh.pk.


Bashkëpunimi është bazuar në një marrëveshje të detajuar që përcakton drejtësitë dhe detyrimet e secilës pale.

Plan Menaxhimit parashikon që shërbimi i çadrave dhe shezlongjeve të ofrohet sipas çmimeve të mëposhtme në varesi të shpërndarjes së tyre.

Shërbimi	Tarifa (ALL)
Çader kashte / Shezlong alumini	300
Çader alumini / Shezlong alumini	500
Çader alumini + kashte / Shezlong dyshek	700
Cabana (Gazebo plazhi)	1500-2000

Tabele 1 Tabela e çmimeve të shërbimit të shezlongjeve






5

MODEL: CADER 300 ALL



MODEL CADER 500ALL




6




MODEL CADER 700 ALL

7



MODEL CADER (GAZEBO) 1500 ALL



PLANI OPERACIONAL

Kostot Operative janë shpenzimet që shoqëria do të duhet të përballojë në baza ditore në mënyrë që të realizojë aktivitetet operacionale.

Në kostot direkte janë përfshirë

Shpenzimet për punëtori e burime njerëzore, duke përfshirë jo vetëm administratën e shoqërisë, por punëtorët e plazhit si dhe vrojtuesit e sigurisë në plazhe. Në këtë kosto janë llogaritur edhe detyrimet për Sigurime Shoqërore e ato Shëndetësore.

Në Detyrimet Fiskale janë llogaritur, Tatimet mbi të ardhura që janë detyrimet që duhet të përlllogarisë punëdhënësi

Tatim Fitimi i ndërmarrjes pas realizimit të fitimit.

Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, i cili përlllogaritet si i zbritshëm midis detyrimit të TVSH në arkëtim dhe TVSH që njihet si shpenzim kur shoqëria realizon shpenzime.

Të Ardhura të parashikuara për vitin 2026.

Shoqëria projektton të arkojë nga shërbimi i çadrave dhe shezlongjeve. Tabela e mëposhtme paraqet parashikim e të ardhurave sipas kategorive të shezlongjeve.

Arkëtimet janë llogaritur për një segment 45 ditor.

Emertimi	Sasia	Cmimi/Njesi	Dite	Totali All
Cader kashte shezlong alumini	300 cope	300 Lek	45	4,050,000
Cader kashte shezlong alumini	300 cope	400 lek	45	5,400,000
Cader alumin shelzong alumin	1500 cope	500 lek	45	33,750,000
Cader alumin +kashte/shezlong dyshe	300 cope	700 lek	45	9,450,000
Gazebo plazhi/Cabana	100 cope	1500 Lek	45	6,750,000
Totali				59,400,000 AL

Ky projekt paraqet nje model te qendrueshem dhe te realizueshem per shfrytesimin sezonal te hapsirave turistike, duke garantuar organizimin funksional te shërbimit te plazhit, standart te larte per pushuesit dhe eficencen ekonomike.



Bazuar ne kapacitetin e parashikuar dhe ne nje sezon operimi prej 45 ditesh,aktiviteti gjeneron te ardhura te konsideruaeshme duke krijuar njekohesisht vende pune sezonale dhe duke rritur oferten turistike lokale.

Investimi eshte i kontrollueshem,me kthim te shpejte financiar dhe potencial zhvillimi ne vitet pasuese per zgjerimit te sherbimeve dhe permirsimit te infrastruktures.

Ne perfundim,projekti perfaqeson nje iniciative konkrete ekonomikisht te leverdisshme dhe ne perputhje me zhvillimin e qendrushem te turizmit



FALEMINDERIT.

9



LEZHA INVEST SHPK

PRILL 2026



Nr. 5809/1 prot
Dt. 07-05-2026

K.B



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 465/4 Prot.

Lezhë më 07.05.2026

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar , ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar ; VKM-në nr.649, datë 16.10.2024 "Për miratimin e Rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" i ndryshuar , konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 38, datë 30.04.2026 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për vënien në dispozicion të ndërmarrjes "Lezha Invest" shpk të stacioneve publike të plazhit në bashkinë e Lezhës dhe përcaktimin e tarifave maksimale për ofrimin e shërbimit në plazhet publike në administrim të "Lezha Invest ".

PREFEKTI

Taulant MALSHI

